



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODOBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.111/2021

Këshilli i Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave në përbërje nga: Jeton Koca-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë dhe Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.111/2021 të datës 01.03.2021 të parashtruar nga ankuesja të cilën me autorizim e përfaqëson Avokate

me adresë Rr. "Sali Çeku" pn, Ferizaj, kundër organit të punësimit/Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosijes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 08.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pa bazuar ankesa me numër A.nr.111/2021 e datës 01.03.2021 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetet në fuqi Vendimi i datës 26.01.2021 i Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

A r s y e t i m

Ankuesja Zyrtare për Shërbime të Punësimit në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës, më datë 25.02.2021 nëpërmjet postës ka parashtruar ankesë me numër protokolli 862/2021 e cila më datë 01.03.2021 është pranuar dhe regjistruar me numër A.nr.111/2021 në Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e të drejtës për kompensimin e tri (3) pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri (3) pagave jubilarë, sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive në Kosovë.



Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjen e Ankesave, më datë 03.03.2021 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë te Agjencia e Punësimit të Republikës së Kosovës. Këshilli me datë 05.03.2021 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegj për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër A.nr.111/2021 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimin e datës 26.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës; Autorizimin e datës 30.12.2020; Listën e pagave të muajit dhjetor 2020; Kontratën e pune të datës 01.03.2000; Akt Emërimit të datës 28.12.2017 të ankueses; Zarkin e postes të datës 25.02.2021; Listën e pagave të muajit shtator 2017 dhe Përgjigjen në ankesë të datës 05.03.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e parashtruar nga ankuesja *është e pa bazuar, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, respektivisht Akt Emërimit me numër protokoli 124 të datës 28.12.2017 është konstatuar se ankuesja është e punësuar në pozitën e punës Zyrtare për Shërbime të Punësimit pran Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës.

Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, më datë 26.01.2021 ka nxjerr vendim për përfundimin e marrëdhënies se punës te ankueses me datë 31.03.2021 për shkak të arritjes së moshës së pensionimit. Me këtë vendim ankueses i është njohur e drejta e realizimit të një pagë përcjellëse sipas dispozitave të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensimet Tjera të Nëpunësve Civil.

Kundër Vendimit të datës 26.01.2021 të Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës, me datë 18.02.2021 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor për njohjen e te drejtës për realizimin e tri (3) pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri (3) pagave jubilarë sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave gjatë shqyrtimit të pretendimeve ankimore te ankueses ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës, e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe ka qenë e zbatueshme vetëm deri me datë 01.01.2018, siç përcaktohet me nenin 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-2012 të Punës. Andaj, meqenëse Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive nuk është në fuqi nga data 01.01.2018, Kolegji vlerëson se pretendimi ankimor i ankueses për kompensimin e tri (3) pagave përcjellëse me rastin e pensionimit dhe tri (3) pagave jubilarë sipas Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, është i pa bazuar.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave lidhur me këtë çështje ka analizuar legjislacionin e aplikueshëm për Shërbimin Civil dhe si rrjedhojë ka konstatuar se çështja e pagave, shtesave

në page dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil janë të rregulluara me Ligjin Nr.03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civil, si dhe Rregulloren Nr.33/2012 për Shtesat në Page dhe Kompensimet Tjera të Nëpunësve Civil, ku bazuar në dispozitat e nenit 19 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Page dhe Kompensimet Tjera të Nëpunësve Civil, Kolegji ka konstatuar se nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën prej një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagës së fundit, andaj bazuar në këtë Kolegji vlerëson se organi i punësimit, respektivisht Agjenci e Punësimit të Republikës së Kosovës ka vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi me rastin e nxjerrjes së Vendimit të datës 26.01.2021, përmes të cilit ankueses i ka njohur të drejtën e kompensimit të një page përcjellëse me rastin e arritjes së moshës së pensionimit. Po ashtu kolegji bazuar në provat e lëndës ka konstatuar se ankuesi gjatë marrëdhënies së punës në Shërbimin Civil ka realizuar dy shpërblime jubilarë sipas nenit 21 të Rregullores Nr.33/2012 për Shtesat në Page dhe Kompensimet Tjera të Nëpunësve Civil, ku shprehimisht përcaktohet se: *Nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë (10) vjetësh pune.*

Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.111/2021

Avdyl BEKTESHI,

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të ankueses Avokates
- Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Punësimit të Republikës së Kosovës;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë e Punësimit të Republikës së Kosovës;
- Arkivit të KPMSHCK-së.

